

SHENIME SHPJEGUESE; Per periudhen 01 Janar deri me 31 Dhjetor 2019.

Ne kete aneks paraqiten informacionet shpjeguese ne lidhje me pergatitjen dhe paraqitjen e pasqyrave financiare te njesise ekonomike BigAlb Group sh.p.k.

Njesia ekonomike BigAlb Group sh.p.k e krijuar me date 23.03.2011 ushtron aktivitetin e saj ne fushen Supermarketeve dhe Administrimin e Aktivitetit te Rrjetit Big Market , Fashti Gropaj, Godina Tirana Cash & Carry, Vaqarr, Tirane .

Per periudhen 01 Janar 2019 deri me 31 Dhjetor 2019 jane pergatitur dhe paraqitur paketa e plote e pasqyrave financiare, te cilat japin pamjen te vertete dhe te drejte te pozicionit financiar, performances financiare dhe fluksit te parase gjate kesaj periudhe.

Pergatitja dhe paraqitja e tyre, e cila eshte pergjegjesi e Drejtimit te subjektit, eshte realizuar mbeshtetur ne Ligjin nr 9228 date 29.04.2004 "Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", ne Standardet Kombetare te Kontabilitetit (SKK) te permiresuara te miratuara nga Keshilli Kombetar i Kontabilitetit(KKK). Gjuha e perdorur eshte gjuha shqipe. Monedha e perdorur eshte monedha Leke. Rrumbullakime te vlerave nuk ka. Ngjarjet dhe trasaksionet jane evidentuar gjate gjithe periudhes ushtrimore ne perputhje me SKK nr 1 Kuadri i pergjithshem per pergatitjen e pasqyrave financiare dhe SKK nr 2 Paraqitja e pasqyrave financiare si dhe cdo standard tjetër kombetar ne perputhje me natyren e ngjarjeve apo trasaksioneve te cilat ne menyre te hollesishme do te jepen ne vijim te informacioneve shpjeguese.

❖ Shenime shpjeguese ne lidhje me zerat e paraqitur ne pasqyren BILANC.

Paraqitja e kesaj pasqyre eshte mbeshtur ne paketen e plote te standardeve te permiresuara te miratuara nga Keshilli Kombetar i Kontabilitetit. Ne vijim do te jepen informacionet shpjeguese per zerat perberes te saj.

I. Informacione Shpjeguese per AKTIVET.

Totali i aktiveve te paraqitura ne pasqyren e Bilancit jane ne vleren **743.698.057 leke** detajimi nepermjet informacioneve shpjeguese i te ciles paraqitet si vijon;

✦ Informacione shpjeguese te AKTIVE AFATSHKURTRA

Aktiveve afatshkurtra jane paraqitur ne vleren **587.972.264 leke** te cilat jane te perbera nga,

1. Aktive monetare 19.433.029 leke. Ky ze eshte paraqitur ne pasqyre duke u mbeshtetur edhe ne SKK nr 12 *Efektet e ndryshimeve te kurseve te kembimit* dhe paraqet tepricen e llogarise Arka dhe tepricen e llogarise banke, ne monedhen lek dhe euro ne date 31.12.2019. Kursi i kembimit eshte perdorur ne menyre sistematike gjate gjithe ushtrimit te aktivitetit te subjektit per ngjarjet e trasaksionet te cilat jane kryer ne monedha te huaja.

2. Investime jane paraqitur ne vleren **271.325.836 leke.** Kjo vlere perbehet nga te gjitha kapitalet qe subjekti Big Alb Group shpk ka derdhur per shoqerite e reja Big Market qe jane hapur gjate vitit 2019 ku eshte aksionere.



2. Te drejta te arketueshme te cilat jane paraqitur ne vleren **270.744.891 leke** dhe eshte e perbere nga;

Zeri, Nga aktiviteti i shfrytëzimit ne vleren **92.561.714 leke**, i cili eshte evidentuar edhe ne perputhje me SKK nr 3 ne te cilen përfshihen të gjitha të drejtat e krijuara gjate periudhes ushtrimore ndaj klientave për shitjen e mallrave, produkteve dhe shërbimeve me arkëtim të mëvonshëm, te paraqitura me vleren neto te realizueshme.

Zeri, Te Tjera ne vleren **151.112.827 lek**, i cili eshte i perbere nga

-Huat Afatshkurtar qe Big Alb Group i ka dhene shoqerive Big Market, apo paleve te treta ne vleren **151.112.827 leke**.

Zeri, Kerkesa ndaj tatim taksave ne vleren **27.070.351 leke**, pëfshihen të gjitha të drejtat e njësisë ndaj të tretëve, te krijuar gjate periudhes ushtrimore i cili eshte i perbera prej;

Tatim fitimi	444	5.484.923
Tvsh	4453	21.295.843
Dogana	4061	28.986
Tatim ne Burim	449	56.199
Te tjera tatime per tu paguar dhe per tu kthyer	447	204.400

3. Inventari i paraqitur ne vleren **23.791.687 leke**, i cili eshte i perbere prej;

Zeri Mallra ne vleren **23.791.687 leke**, mallra per rishitje jane njohur dhe vleresuar ne perputhje me SKK nr 4 *Inventaret*. Kostoja e inventarit eshte vleresuar me metoden e koston mesatare te ponderuar

4. Shpenzime te shtyura, ne vleren **2.676.821 leke**.

↓ Informacione shpjeguese te **AKTIVET AFATGJATA**

Aktivet afatgjata jane paraqitur ne Vleren Kontabel Neto **155.725.793 leke**. Ato jane evidentuar edhe ne perputhje me SKK nr 5 Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jomateriale. Paraqitja e tyre eshte bere nepermjet politikës kontabel Metoda e Kostos. Perberja e ketij zeri paraqitet si vijon;

1. Aktive afatgjata materiale jane ne vleren **155.725.793 leke** dhe eshte i perbere nga zeri

Toka dhe Ndertesa ne vleren **130.219.450 leke**. Metoda e perzgjedhur per amortizimin eshte metoda mbi vleren e mbetur , dhe eshte njohur ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve per periudhen ushtrimore ne vleren **2.996.806 leke**.

Pajisje Kompjuterike ne vleren **1.663.644 leke**. Metoda e perzgjedhur per amortizimin eshte metoda mbi vleren e mbetur , dhe eshte njohur ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve per periudhen ushtrimore ne vleren **451.088 leke**.



Të tjera Instalime dhe pajisje ne vleren **23.842.699 leke**. Metoda e perzgjedhur per amortizimin eshte metoda mbi vleren e mbetur , dhe eshte njohur ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve per periudhen ushtrimore ne vleren **3.058.894 leke**

Ne te jane te perfshire elementet e meposhtem;

Nr. Llogarie	Emertimi i Llogarise	Monedha	Debi	Kredi
2181	<i>Të tjera Instalime dhe pajisje</i>	LEK	37.029.945	
2182	<i>Pajisje Kompjuterike,</i>	LEK	3.346.078	
2122	<i>Ndertesa</i>	LEK	138.915.058	
281801	<i>Per Të tjera Instalime dhe pajisje</i>	LEK		13.187.246
281802	<i>Per Pajisje Kompjuterike, Pajisje Zyre</i>	LEK		1.682.434
281803	<i>Per Ndertesa</i>	LEK		8.695.608

II. Informacione Shpjeguese per DETYRIMET.

Detyrimet e paraqitura ne pasqyren e Bilancit jane ne vleren **236.864.917 leke** dhe perbehet vetem nga detyrime te periudhave afashkurtra. Detajimi jepet nepermjet informacioneve shpjeguese si vijon;

✦ Informacione shpjeguese te DETYRIMEVE AFATSHKURTRA

Detyrimet afatshkurtra jane paraqitur ne total ne vleren **222.862.516 leke**, dhe jane te perbera nga detyrimet ndaj furnitoreve, punonjesve , detyrime ndaj shtetit per tatime dhe taksa.

- Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit ne vleren **221.740.600 leke** paraqesin detyrimin e papaguar per blerjen e mallrave nga furnitore te ndryshem te njesise ekonomike ne fund te vitit 2019.

- Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve shoqërore/shëndetsore ne vleren **1.121.916 leke** perbejne vetem detyrimin per pagat e personelit te papaguara deri ne fund te vitit 2019 si dhe detyrimin per sigurimet shoqerore dhe shendetsore per muajin Dhjetor 2019, i cili detajohet si vijon;

Elementi	Ref	Vlera
Sigurime Shoqerore	431+442	1.121.916

Informacione shpjeguese te DETYRIMEVE AFATGJATA

Detyrimet Afatgjata jane paraqitur ne total ne vleren **14.002.402 leke**, dhe jane te perbera nga

-Detyrime ndaj institucioneve të kredisë **13.506.422 leke** .

- Fonde nga punonjesit Big Market per fatkesqine natyrore **495.980 leke**

III. Informacione Shpjeguese per KAPITALIN

Kapitali i paraqitur ne vleren **506.833.140 leke** dhe eshte i perbere nga zerat Kapital i nenshkruar, Fitime te Pashperndara dhe Fitim / Humbje e vitit, detajimi i te cilave do te jepet ne informacionet shpjeguese.

1.Informacione shpjeguese te zerit KAPITAL

Ne kete ze jane paraqitur kapitali i kontribuar nga aksionerët ose nga ortakët dhe jane përmbledhur tepriçat kreditore të llogarive vijuese:

Emertimi	Ref	Vlera
Kapitali i paguar,	101	105.800.000
Totali		105.800.000 leke

2.Informacione shpjeguese te zerit REZERVA TE TJERA

1- Rezerva Ligjore ne vleren **661.600 lek**

2- Rezerva te tjera ne vleren **59.697 lek**

3.Informacione shpjeguese te zerit FITIME NGA FILIALET

Zeri *Fitime nga Filialet* paraqitet ne vleren **178.377.356 leke** dhe perfshin fitimet qe njesite ekonomike ku Big Alb Group Shpk eshte ortak duhet ti derdhin kesaj te fundit .

4.Informacione shpjeguese te zerit FITIM I PASHPERNDARE

Zeri *Fitim i pashperndare* paraqitet ne vleren **223.245.525 leke** dhe paraqitet rezultati i periudhës paraardhese të njësisë .

5.Informacione shpjeguese te zerit FITIM / HUMBJE E VITIT

Zeri *Fitim / Humbje e vitit* paraqitet ne vleren **-1.311.038 leke** dhe paraqitet rezultati i periudhës rrjedhese ushtrimore të njësisë raportuese ashtu si rezulton nga pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve pasi eshte zbritur tatimi mbi fitimin.



❖ **Shenime shpjeguese ne lidhje me zerat e paraqitur ne pasqyren TE ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE.**

Pasqyra e te Ardhurave dhe Shpenzimeve eshte paraqitur bazuar ne klasifikimin e shpenzimeve sipas natyres. Ne kete periudhe ushtrimore ka rezultuar nje humbje ne vleren **-1.311.038 leke**.

Zeri Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit te paraqitura ne pasqyre evidenton te gjitha shitjet dhe Sherbimet e realizuara me vleren e tyre neto **431.364.910 leke**.

Zeri Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme te paraqitura ne vleren **334.961.077 leke** perfaqesojne koston e mallrave te blera per qellime rishitje. Politika kontabel eshte paraqitur me larte ne zerin *Mallra per shitje* (Inventar).

Zeri Shpenzime të personelit i cili eshte i paraqitur ne vleren **39.304.680 leke** perfaqeson:

1. **Shuma Paga dhe shpërblime** gjate periudhes ushtrimore 01.01.2019- 31.12.2019 ne vleren **34.207.657 leke**
2. **Shuma Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetsore (paraqitur veçmas nga shpenzimet për pensionet)** gjate periudhes ushtrimore 01.01.2019-31.12.2019 ne vleren **5.097.023 leke**.

Zeri Shpenzime Konsumi dhe amortizimi te cilat jane te paraqitura ne vleren **6.506.788 leke** .

Zeri Shpenzime të tjera shfrytëzimi te cilat jane te paraqitura ne vleren **47.859.150 leke** perfaqesojne shpenzimet te cilat jane kryer per zhvillimin e aktivitetit te njesise ekonomike, dhe perfaqeson zera te shpenzimeve si furnitura, taksa te ndryshme dhe te tjera.

Zeri Shpenzime të tjera financiare te cilat jane te paraqitura ne vleren **681.461 leke**, perfaqesojne shpenzimet per komisionet e bankare , si dhe interesat per Huan .

Zeri Shpenzimi aktual i tatim fitimit eshte i paraqitur ne vleren **3.362.792 leke**



❖ **Shenime shpjeguese ne lidhje me zerat e paraqitur ne pasqyren CASH FLOW.**

Ne pasqyren e flukseve monetare jane paraqitur flukset hyrese dhe dalese te mjeteve monetare në njësinë ekonomike gjatë periudhës korrente kontabël. Paraqitja eshte bere sipas metodes indirekte.

Gjate periudhes kontabel ka rezultuar;

Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit ne vleren **-76.044.609 leke**. Fluksi negativ ka ardhur pasi flukset dalese te mjeteve monetare per kryerjen e shpenzimeve si psh, paga, detyrime per kontribute te sigurimeve dhe te tatim-taksave jane me te larta se flukset hyrese te mjeteve monetare gjate ushtrimit normal te aktivitetit nga njesia ekonomike dhe investimeve ne filialet e reja.

Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit ne vleren **93.280.253 leke**. Fluksi pozitiv ka ardhur si pasoje Fitimeve nga Filialet.

Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit ne vleren **-50.000.000 leke**.

❖ **Shenime shpjeguese ne lidhje me zerat e paraqitur ne pasqyren NDRYSHIMEVE TE KAPITALIT .**

Ndryshimet ne zerin Kapital kane ardhur si rezultat;

1. Fitim / Humbje e vitit ne vleren **(1.311.038) leke**.
2. Fitimi nga Filialet ne vleren **178.377.356 leke**

Informacionet shpjeguese per zerat e mesiperm jane dhene ne pasqyren e Bilancit.

Drejtuesi

Elona Koshi



Hartues

Jonida Kumaraku

